



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

Bazuar në nenin 3 të Rregullores Nr. 08/2017 për Praktikantë në Gjykata dhe Sekretariatit e KGJK-së, për praktikantë vullnetarë (pa pagesë), për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti,

**Gjykata Themelore në Ferizaj**

Shpall:

**K O N K U R S**

**Nr.01/2023**

**Titulli i vendit të punës: Praktikantë**

1. Gjykata Themelore në Ferizaj ..... tridhjetë (30) pozita,
2. Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik ..... dhjetë (10) pozita dhe
3. Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë ..... tri (3) pozita.

**Pozita Nr.1**

**Titulli i pozitës: Praktikantë**

**Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj**

**Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një (1) viti, pa pagesë.**

**Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Administratori i Gjykatës**

**Pozita Nr.2**

**Titulli i pozitës: Praktikantë**

**Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik**

**Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një (1) viti, pa pagesë.**

**Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Ndihmës Administratori i Gjykatës**

**Pozita Nr.3**

**Titulli i pozitës: Praktikantë**

**Vendi i punës: Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega në Shtërpçë**

**Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, në kohëzgjatje prej një (1) viti, pa pagesë.**

**Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë: Ndihmës Administratori i Gjykatës**

## **Përshkrimi i detyrave të punës:**

**Detyrat e praktikantit:** Ndhmon zyrën e administratës në organizimin dhe ruajtjen e lëndëve si dhe menaxhimin e tyre në përgjithësi.

## **Detyrat kryesore:**

- Vepron nën mbikëqyrjen e Administratorit të Gjykatës / Ndhmës Administratorit;
- Ndhmon punën në zyrën e administratës lidhur me organizimin dhe ruajtjen e lëndëve si dhe në menaxhimin e tyre në përgjithësi;
- Ndhmon gjyqtarët në punët që kanë të bëjnë me futjen e shkresave të lëndëve në dosje;
- Ndhmon në punën e zyrave të ndryshme në Gjykatë / Degë të Gjykatës duke përfshirë regjistrimin e shkresave të lëndës etj,
- Kryen edhe punë tjera sipas nevojës së Gjykatës.

## **Kualifikimet:**

- Diplomë e Fakultetit Juridik, programi i studimeve katër (4) vjeçare, apo 240 kredi ECTS ose Master;
- Njohuri të procedurave gjyqësore;
- Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- Njohuri të mjaftueshme ligjore dhe
- Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë për përpilimin e dokumenteve ligjore si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

## **VËREJTJE:**

- Procedura e konkursit është e hapur për kandidatë të jashtëm.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil, Nr. 03/L- 149, Rregullores, Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregullores Nr. 08/2017 për Praktikantë në Gjykata dhe Sekretariatin e
- KGJK-së.
- **Konkursi është publikuar me datë 26/09/2023 dhe mbyllet me datë 10/10/2023.**

Aplikacionet mund t'i merrni në **Zyrën e Pranimit** në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Rr. Sali Çeku" pn. si dhe në degët e Gjykatës në Kaçanik dhe Shtërpcë, dhe po ashtu, aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Web portalin e Gjykatës Themelore në Ferizaj: [www.gjyqesori-rks.org](http://www.gjyqesori-rks.org).

### **[Shkarko Aplikacionin](#)**

Aplikacionet e plotësuara mund t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Ferizaj, Rr. Sali Çeku" pn. si dhe në degët e Gjykatës në Kaçanik dhe Shtërpcë dhe përmes postës - kodi postar 70000.

- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të

drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, si specifikohet në Nenin 11, par.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

**Aplikacioni e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.**

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi dhe pozita për të cilën konkroni.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:**

- Kopja e diplomës apo certifikatës universitare,
- Kopja e letërnjoftimit dhe
- Certifikatën që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale.

**Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e dhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.**

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkëngjitura në aplikacion, kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.
- Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësie mund të kontaktoni në numrat e tel./fiks: **0290/ 321 009 dhe 0290/ 320 261.**